

Pranuar me dt. 26.10.2022			
Njesia orga	Num	Nr.Ekzemi	Vlera
	2538		



UNIVERSITETI / UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË
Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore

Pranuar me dt. 26.10.2022			
Njesia organ.	Numer	Nr.Ekzempli	Vlera
	478/2		

Këshilli i Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore, duke u bazuar në nenin 72 të Statutit të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë, nenit 9 të Rregullores nr. Prot. 1670, dt. 28.09.2021 për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin "Isa Boletini" në Mitrovicë, dhe nenit 22 pika 1 të Rregullores mbi zgjedhjet në Universitetin e Mitrovicës dhe punën e Këshillit të Fakultetit, më datë 25.10.2022 merr këtë:

VENDIM

- I. Këshilli i Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore në mbledhjen e mbajtur me datë 25.10.2022 ka shqyrtuar dhe miratuar raportin e komisionit të ankesave dhe parashtrësive, të emëruar nga Këshilli i Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore, sipas konkursit të shpallur, nr. Prot. 2046 të datës 14.09.2022 të UIBM-së, për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjerata dhe ushtrime në bazë të nevojave të njëjësive akademike të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë.
- II. **APROVOHET** si e bazuar ankesa e parashtrueses Ylberinë Baliu, me numër protokoli 442 e dates 17.10.2022, kundër përzgjedhjes së kandidatit të suksesshëm nga komisioni vlerësues.
- III. **ANULOHET** konkursi i shpallur për pozitën **Një asistent për lëndët: Trajtimi i ujërave të zeza I; Monitorimi i ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore; Teknologjia e ujit dhe përpunimi i ujërave të ndotura; Trajtimi i ujërave të zeza II; Materiet ndotëse në produktet ushqimore,**

Arsyetim

Komisioni vlerësues ka bërë përzgjedhjen e Teuta Abazit si kandidat i suksesshëm për pozitën një asistent për lëndët e lartëcekura. Parashtruesja e ankesës duke shfrytëzuar mjetet juridike, brenda afateve ligjore ka ankimuar propozimin e komisionit vlerësues. Komisioni i ankesave dhe parashtrësive, pas shqyrtimit dhe analizës së pretendimeve të parashtrueses ka gjetur se, përveç tjerash, janë bërë edhe shkelje procedurale.

Bazuar në gjetjet e komisionit të ankesave dhe parashtrësive, Këshilli i Fakultetit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Bashkëngjitur gjeni raportin e komisionit të ankesave dhe parashtrësive.

I dorëzohet:

Zyrës për çështje akademike

Arkivit të fakultetit

Kryesuesi i Këshillit të Fakultetit



Prof. Asoc. Dr. Milaim Sadiku



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË
Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore

UNIVERSITETI ISA BOLETINI MITROVICË
REKTORATI

Pranuar me dt. 26.10.2022			
Nësia orga	Num	Nr. Ekzant	Vlera
	2538/1		

Nr. Prot. 473 Dt. 21.10.2022

Komisioni për Ankesa dhe Parashtrësia në Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore, pas mbajtjes së mbledhjes të datës 21.10.2022, për shqyrtimin e ankesës të kandidatës Ylberinë Baliu (tani e tutje parashtruesja), ndaj procedurave për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjerata dhe ushtrime, në kolegji nxjerr këtë:

RAPORT

I. **APROVOHET** e bazuar ankesa e parashtrueses, kunder përzgjedhjes për kandidatin e suksesshëm nga komisioni vlerësues.

Arsyetim

I. Rrethanat e rastit

Me 14.09.2022, Universiteti "Isa Boletini në Mitrovicë ka shpallur konkurs nr. Prot. 2046, për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjerata dhe ushtrime.

Më 20.09.2022, Këshilli i Fakultetit i Teknologjisë Ushqimore (Këtu e tutje: Këshilli i Fakultetit) caktoi Komisionin vlerësues.

Me 04.10.2022, komisioni vlerësues përpiloi raportin vlerësues (nr.Prot. 439).



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
“ISA BOLETINI”
MITROVICË
Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore

Me 11.10.2022, është publikuar raporti i komisionit vlerësues në Buletinin.

Me 17.10.2022, parashtruesja ka paraqitur ankesë (Nr. Prot.462) në Komisionin për Ankesa dhe parashtrësja në Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore (Këtu e tutje: Komisioni i Ankesave) kundër raportit të komisionit vlerësues sipas Buletinit të publikuar me 11.10.2022).

Më 21.10.2022, Komisioni i Ankesave dhe Parashtrësive shkroi Raport (Nr. Prot. 473), me të cilin konstatoj të bazuar ankesën e parashtrueses, Ylberinë Baliu, përkatësisht mohoj Raportin e Komisioni Vlerësues për kandidatin e suksesshëm, Teuta Abazi të zgjedhet asistente bashkëpunëtore e jashtme për ushtrime në lëndët: Trajtimi i ujërave të zeza I, Monitorimi i ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, Teknologjia e ujit dhe përpunimi i ujërave të ndotura, Trajtimi i ujërave të zeza II, Materiet ndotëse në produktet ushqimore.

II. Pretendimet e parashtrueses

1. Në Raportin e komisionit vlerësues sipas konkursit për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm, i publikuar në faqën zyrtare të Universitetit me datën 11/10/2022 dhe numër protokoli 234 1/6, në Tabelën I është dashur të përshkruhet *Përmbledhja e aktivitetit shkencor të kandidatit*, që në rastin tim nuk është përshkruar nga komisioni vlerësues edhe pse kam dorëzuar kopjen e punimit ku kam qenë bashkëautorë e po ashtu edhe linkun e punimit në CV-në time. Është edhe më e çuditshme mosparaqitja e këtij punimi në Raponin vlerësues nga komisioni kur dihet se ky punim është punuar pikërisht në Universitetin "Isa Boletini" së bashku me profesorë të këtij universiteti e madje ky punim është përmendur edhe në procedurat e akreditimit të Universitetit.
2. Në Tabelën IV të Raportit të komisionit vlerësues është dashur të përshkruhen *Publikimet nga kongreset, konferencat, simpoziumet, në nivel ndërkombëtar dhe vendor*, por në rastin tim nuk janë përshkruar dy publikime nga konferencat e përbashkëta Ballkanike edhe pse unë kam dorëzuar agjendat e dy konferencave dhe referencë nga organizatorët e konferencave e po ashtu në CV-në time kam bashkangjitur edhe linqet e prezantuesve në këto konferenca.
3. Në pikën 3 të Raportit të komisionit vlerësues ku duhej të përshkruheshin *Përvojat menaxhuese, angazhimet profesionale dhe udhëhëqja në hulumtim e kandidatit/es*, komisioni ka vlerësuar se unë kam kryer disa trajnime dhe kurse të ndryshme profesionale të cilat janë paraqitur në CV-në time. Përvoja ime e punës rreth 4 vjeçare në fushën e menaxhimit të ujërave të ndotura, nga komisioni



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
“ISA BOLETINI”
MITROVICË
Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore

është vlerësuar si trajnim apo kurs, madje në rapon as nuk është shkruar saktë pozita që mbaj qe rreth 4 vite. Në CV-në time është shumë qartë e shkruar në gjuhën shqipë përvoja e punës, pozita dhe përgjegjësitë që mbaj gjatë këtyre viteve. E për ta vërtetuar këtë përvojë, dokumentacionit me të cilin kam aplikuar ia kam bashkangjitur vërtetimin për përvojën e punës të nënshkruar dhe vulosur nga punëdhënësi im si dhe pasqyrën e trustit. Përndryshe, për çdo përvojë pune, trajnim apo kurs të paraqitur në CV-në time, kam bashkangjitur edhe dokumentin përkatës që e vërteton atë. Prandaj, në asnjë moment nuk është e drejtë që përvoja ime e punës në këtë fushë të re dhe mjaft sfiduese në vendin tonë, të barazohet me një trajnim apo kurs e sidomos nga një komision profesional i cili duhet ta dijë vlerën e përvojës s.e punës në industri.

4. Në pikën 4 të raportit të komisionit vlerësues është dashur të përshkruhet *Mobiliteti i kandidatit/es*, por, edhe kjo mungon në raport, në fakt komisioni e ka përshkruar tek trajnimet dhe kurset e ndjekura nga unë. Falë bashkëpunimit që UIBM ka me Universitetin e Shkencave të Aplikuara Van Hall Larenstein në Holandë, kam fituar mobilitetin nga Erasmus+ ku nga data 01.02 .2019 deri 28.06.2019 kam ndjekur një semester në këtë universitet në Shkencat e Mjedisit në kuadër të UIBM. Dokumentacionit me të cilin kam aplikuar për pozitën bashkëpunëtoare e jashtme për ushtrime ia kam bashkangjitur edhe certifikatën e mobilitetit. Këtë mobilitet e kam fituar në kuadër të UIBM, jo ilegalisht, prandaj nuk e kuptoj përse mobiliteti nuk është përshkruar në raponin e komisionit vlerësues tek pika për mobilitet të kandidatit? Konsideroj se në katër pikat e mësipërme është vepruar në kundërshtim me pikën 10 dhe pikën 12 të nenit 6 të Rregullores nr. 1670 të datës 28.09.2021, për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtoareve të jashtëm në Universitetin "Isa Boletini" në Mitrovicë.
5. Më datën 06. 10.2022 kam pranuar një thirrje nga Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore më ç'rast më kanë njoftuar se jam zgjedhur në mesin e ngushtë të kandidatëve të cilët kanë aplikuar për pozitën e cekur në këtë ankesë dhe jam ftuar në intervistë për të nesërmen, data 07. 10.2022. Çuditërisht, intervista ka qenë me shkrim, ose thënë më saktë ka qenë provim (testim). Për një moment, në shenjë revolte, nuk kam dashur as të hyj në test, por për të shmangur dramën dhe për të mos e dorëzuar testin blanko kam hyrë në test duke shpresuar në reflektimin e komisionit. Në asnjë pikë të Rregullores nr. 1670 të datës 28.09.2021, për procedurat vlerësuese lidhur më angazhimin e bashkëpunëtoareve të jashtëm në UIBM, nuk përmendet se kandidatët duhet të testohen. Edhe nëse do të ishte ashtu do të duhej të lajmëroheshim jo më pak se 8 (tëtë) ditë përpara datës së testimit dhe besoj shumë se anëtarët e komisionit janë në dijeni për këtë sepse për teste të tilla si ai në të cilin kemi hyrë në atë ditë kërkohet rishikimi i literaturës.
6. Kandidatja të cilën komisioni vlerësues i propozon Këshillit të Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore të zgjedhet asistente bashkëpunëtoare për lëndët Trajtimi i ujërave të zeza I, Monitorimi i ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, Teknologjia ujit dhe përpunimi i ujërave të ndotura, Trajtimi i ujërave të zeza II, Materiet ndotëse në produktet ushqimore, gjatë studimeve i ka ndjekur vetëm tri nga këto lëndë që janë, Trajtimi i ujërave të zeza I, Monitorimi i ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, Trajtimi i ujërave të zeza II. Ndërsa në rastin tim lëndët, Trajtimi i ujërave të zaza I dhe Trajtimi i ujërave të zeza II korrespondojnë me lëndët e ndjekura gjatë mobilitetit në Universitetin Van Hall Larenstein në Holandë, lëndën Teknologjia e ujit dhe përpunimi i ujërave të ndotura e kam ndjekur gjatë studimeve bachelor në UIBM, ndërsa për lëndën Materiet ndotëse në produktet ushqimore, konsideroj se kam më shumë përparësi se sa kandidatja e propozuar nga komisioni



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
“ISA BOLETINI”
MITROVICË
Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore

vlerësues duke qenë se jam e fushës së ushqimit. Kosideroj se në bazë të të gjitha pikave të paraqitura më lartë është vepruar në kundërshtim me nenin 8 të Statutit të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë.

III. Meritat e rastit

Gjatë vlerësimit të raportit të Komisionit vlerësues për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm për vitin akademik 2022/2023, me nr. Prot. 2046 të datës 14.09.2022 për pozitën Asistent në lëndët: Trajtimi i ujërave të zeza I, Monitorimi i ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, Teknologjia e ujit dhe përpunimi i ujërave të ndotura, Trajtimi i ujërave të zeza II, Materiet ndotëse në produktet ushqimore, është konstatuar se komisioni vlerësues nuk i ka ofruar të dhënat e plota për kandidaten Ylberinë Baliu. Të gjeturat janë dhënë në vijim:

- Mospërfshirja e të gjitha punimeve shkencore të publikuara nga ana e kandidatës Ylberina Baliu. Të gjitha këto publikime janë në fushën përkatëse, të dëshmuara në dokumentacionin e kandidatës
- Nuk është marrë parasysh përvoja e punës 4 vjeçare e kandidatës Ylberina Baliu në fushën e menaxhimit të ujërave të ndotura, e dokumentuar nga ana e kandidatës.
- Tek rubrika e mobilitetit nuk është shënuar saktë nga cila datë deri kur ka zgjatë mobiliteti i kandidatës Ylberina Baliu, por është shënuar tek trajnimet dhe kurset e ndjekura nga kandidatja. Në realitet Ylberina Baliu falë bashkëpunimit që ka UIBM me Universitetin e Shkencave të Aplikuara Van Hall Larenstein në Holandë, nëpërmjet Erasmus+ ka fituar mobilitetin nga data 01.02.2019 – 28.06.2029, pra një semester.
- Asnjë pikë e rregullores nr.1670 date 28.09.2021 në lidhje me procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UIBM nuk thotë se kandidatet duhet të testohen përkatësisht të futen në provim. Pra, këtu kemi veprim të kundërligjshëm pasi kandidatet janë thirrur nga komisioni vlerësues t'i nënshtrohen provimit.
- Kandidatja e cila është përzgjedhur si e sukseshme nga Komisioni Vlerësues rezulton se dy lëndë ose 40% të lëndëve në të cilat ka aplikuar nuk i ka dëgjuar përkatësisht në njërin prej tyre nuk është as e fushës. Kandidatje tjetër e cila pretendon se lëndët Trajtimi i ujërave të zeza I dhe trajtimi i ujërave të zeza II korrespondojnë me lëndët e dëgjuara gjatë mobilitetit, nësi Komisioni i Ankesave nuk kemi kompetencë të vlerësimit. Një lëndë nga lëndët e konkursit e ka dëgjuar dhe për tjetrën megjithatë është e fushës.

Pasi janë gjetur lëshimet e cekura më lartë nga ana e komisionit vlerësues për zgjedhjen e kandidatëve kërkohet që të anulohet Raporti i Komisionit Vlerësues për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
“ISA BOLETINI”
MITROVICË
Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore

cilësisë së ushqimit dhe Teknologjia e mishit, Komisioni vlerëson se zgjedhja e Arbnora Durmishaj asistente bashkëpunëtoe është bërë në përputhje me Rregulloren me numër protokollit 1670, datë 28.09.2022, për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtoe të jashtëm në UIBM. Pretendimet e parashtrues së ankesës se nota më e lartë mesatare është kriter bazë në përzgjedhjen e kandidatëve nuk qëndron.

Fra, ankesa e parashtruese së ankesës refuzohet e pabazë.

Kryetare e Komisionit: Besire Cena

Anëtare e Komisionit: Malësore Pllana

Anetar i Komisionit: Arbër Hyseni

Raporti i dërgohet:

1. Arkivit të Fakultetit
2. Të përmendurit/es

21.10.2022

Mitrovicë